

## Mirë se vini në Zvicër

Kjo broshurë i dedikohet të gjithë lexuesve të cilët dëshirojnë të kenë një pasqyrë të përgjithëshme rreth konfederatës së Zvicrës. Me anë të kësaj broshure jemi munduar që ti nxjerrim të gjitha elementet bazë për njohjen e gjërave kryesore që e karakterizon një shtet të zhvilluar sikurse që është Zvicra.

1. Hyrja
2. Kantonet
3. Historia
4. Arti dhe Kultura
5. Gjeografia
6. Popullsia
7. Qeveria
8. Ekonomia
9. Telekomunikacioni
10. Transporti
11. Turizmi
12. Shoqëria
13. Emigrantet
14. Burimet



### Hyrja

Mirësevini në Zvicër!

Mirëse vini në Zvicër, njërin ndër shtetet më moderne në botë, me standartet më të larta, natyrën më atraktive, administrim më demokratike në botë si dhe shumë e shumë gjëra që e bëjnë Zvicrën të krenohet në shumë aspekte, me një fjalë mund të thuhet se në Zvicër populli vendos për gjithçka. Zvicra është e njohur edhe si "Confoederatio Helvetica", shkurt CH. "Confoederatio" qëndron për "konfederatë", "Helvetica" rrjedh nga latinishtja "Helvetier" është emri i popullit i cili ka jetuar në zonat ku sot është Zvicëra prandaj CH mirret edhe si simbol i Zvicrës duke u përdorur në shumë gjëra që përfaqson shtetin e Zvicrës.

Siq e dini Zvicra ka flamurin e kuq me një kryq të bardhë në mes i cili ka një domethenie fetare. Kryqi përfaqëson kqyrin, ku Jezusi është vënë brenda dhe ngjyra e kuqe përfaqëson gjakun e tij. Secili krah i kryqit duhet të jetë i madhësisë së njëjtë dhe duhet të jetë 1/6 më i gjatë se sa i gjërë. Zvicra nuk ka gjëra të tilla si një moto kombëtare, një lule kombëtar apo një kafshë kombëtare. Megjithatë, disa kantone kanë një moto, ose një kafshë. "Edelweiss" ka statusin e një lule jo zyrtarisht kombëtare. Kqyeqyteti i Zvicrës është Berni që renditet qyteti i katërt për nga numri i popullsisë ndërsa qyteti me më së shumti banorë është Cyrihu me rreth 1,2 milion dhe pastaj vijin Gjeneva dhe Bazeli.

Ekonomia e Zvicrës është një nga ekonomitë më stabile në botë. Politika e saj e afatgjatë e sigurisë monetare dhe stabiliteti politik ka bërë Zvicra të jetë një strehë i sigurt për investitorët, duke krijuar një ekonomi që është gjithnjë e varur nga një valë e qëndrueshme e investimeve të huaja. Për shkak të përmasave të vogla të vendit dhe specializimit të lartë të punës, industria dhe tregtia janë çelësat për jetesë ekonomisë së Zvicrës. Zvicra ka arritur të ardhurat për kokë banori një nga më të larta në botë me shkallën e papunësisë të ulët dhe një buxhet të balancuar. Sektori i shërbimeve ka luajtur një rol të rëndësishëm ekonomik.

Në krahasim me vendet tjera evropiane numri i të huajve që marrin shtetësinë zvicerane, është mjaft i ulët, ndonëse një në çdo 10 të rritur që mbajnë shtetësinë zvicerane në vitin 2001 kishte fituar atë nëpërmjet natyralizimit. Ndërmjet viteve 1992 dhe 2005 numri vjetor i natyralizimit është trefishuar ku 3/4 e tyre vijn nga evropa dhe 1/3 ishtin të lindur në Zvicër. Një e treta e njerëzve që jetojnë në Zvicër në të njëjtin vit ishin ose vetë emigrantët apo pasardhësit e emigrantëve, sipas Zyrës Federale të Statistikave.

**Kantonet**

Kofederata e Zvicrës përbëhet prej 26 kantoneve prej të cilëve 3 quhen edhe si gjysëm kantone. Secili kanton e ka kushtetutën e vet, qeverinë, parlamentin, gjykatat dhe ligjet e veta, edhe pse ato duhet natyrisht të jenë të pajtueshme me ato të Konfederatës. Kantonet gëzojnë një autonomi të madhe administrative dhe lirinë e vendim-marrjes. Ata kanë kontroll të pavarur mbi sistemet e tyre të arsimit dhe shërbimeve sociale, dhe secili ka forcën e saj policore. Çdo kanton gjithashtu përcakton nivelin e vet të taksave.

Shkurt	Kantoni	Kryeqyteti	Prej	Banorë	Sip. km <sup>2</sup>	Den. km <sup>2</sup>	Nr. i komunave	Gjuha zyrtare
AG	Aargau	Aarau	1803	612611	1404	388	220	De
AI	A. Innerrhoden	Appenzell	1513	15688	173	87	6	De
AR	A. Ausserrhoden	Herisau	1513	53017	243	220	20	De
BE	Bern	Bern	1353	979802	5959	158	383	De, Fr
BL	Basel Landschaft	Liestal	1833	275536	518	502	86	De
BS	Basel Stadt	Basel	1501	191542	37	5072	3	De
FR	Fribourg	Fribourg	1481	278493	1671	141	167	Fr, De
GE	Geneve	Geneve	1815	466536	282	1442	45	Fr
GL	Glarus	Glarus	1352	38608	685	51	3	De
GR	Graubünden	Chur	1803	192621	7105	26	180	De, Ro, It
JU	Jura	Delemont	1979	70197	839	82	64	Fr
LU	Luzern	Luzern	1332	37760	1493	233	87	De
NE	Neuchatel	Neuchatel	1815	172021	803	206	53	Fr
NW	Nidwalden	Stans	1291	41024	276	138	11	De
OW	Obwalden	Sarnen	1291	35585	491	66	7	De
SH	Schaffhausen	Schaffhausen	1501	76356	298	246	27	De
SZ	Schwyz	Schwyz	1291	146730	906	143	30	De
SO	Solothurn	Solothurn	1481	256888	790	308	122	De
SG	St. Gallen	St. Gallen	1803	478907	2026	222	85	De
TI	Ticino	Bellinzona	1803	333753	2812	110	157	It
UR	Uri	Altdorf	1291	35422	1077	33	20	De
VS	Valais	Sion	1815	312684	5224	53	143	Fr, De
VD	Vaud	Lausanne	1803	713281	3212	188	339	Fr
TG	Thurgau	Frauenfeld	1803	244330	991	229	80	De
ZG	Zug	Zug	1352	113105	239	416	11	De
ZH	Zürich	Zürich	1351	1371007	1729	701	171	De

Të gjithë domeinat zyrtar të kantoneve përbëhen nga dy germa si shkurtesa të kantoneve të cilat i gjeni në kolonen e parë dhe mbarojn me prapashtesën .ch si shembull kantoni Cyrich (Zürich) e ka [www.zh.ch](http://www.zh.ch)

Në portalet zyrtare gjindet të gjitha informacionet rreth kantonit dhe shërbimeve tjera të atij kantoni.

### Historia

Historia moderne zvicerane konsiderohet se ka fillu nga viti 1291 me themelimin e konfederatës së parë zvicerane nga 3 kantonet Uri, Schwyz dhe Unterwalden (sot Nidwalden dhe Obwalden) por thuhet se njërezit kanë jetuar edhe më herët dhe ndër fiset përmendet fisi Celtic.

Në vitin 1315, Duka Leopold (Armata e Habsburgut) dërgoi një ushtri të fuqishme austriake për ta shkatërruar këtë komb në rritje por trupat zvicerane i mposhten në vendin e quatur Morgarten. Me fitimin e kësaj beteje komunitetet (kantonet) tjera filluan ti bashkohën konfederatës kështu në vitin 1332 i bashkohet Luzerni, pastaj në vitin 1351 Zurich, 1352 Glarus dhe Zug, 1353 Bern, 1481 Fribourg dhe Solothurn, 1501 Basel dhe Schaffhausen, 1513 Appenzell. Gjatë kohës së bashkimit të kantonëve konfederata e Zvicrës fitoj pavarësinë nga perandori i shenjtë romak Maksimiliani I pas një fitore në Dornach në vitin 1499.

Pas themelimit të konfederatës për 200 vite zviceranet kishin fitore nëpër betejat që i kishin bërë por në vitin 1515 pas një bashkimi të forcave Franceze dhe Venedikut pësuan humbje në vendin e quatur Marignano (afër Milanos). Kjo humbje ishte edhe një nxitje ku për her të parë largohen nga skena ndërkombëtare dhe deklarojn neutralitetin. Në këtë kohë konfederata kishte 13 kantone ndërsa mercenarët zviceran pas deklarimit të neutralitetit kanë shërbyer në ushtri të huaja ku si shembull kemi garden zvicerane e cila shërben në Vatikan në shërbim të Papës.

Pas neutralitetit edhe pse Zvicëra kishte disa të drejta për tu mbrojtur nga lufërat, në vitin 1618 shpërtheu lufta fetare 30 vjeqare (reformat protestante dhe katolike) e cila i shkaktoi pak mundim dhe kjo ndikoi pasi që në vitin 1519 Huldrych Zwingli kishte fillu ti mësoj fjalët protestant në Zürich si dhe Jean Calvin në Gjenevë por Zvicra qendrore mbeti katolike kështu që konfederata nuk ka mundur të vendos se në cilën anë të marrë pjesë në luftë. Gjatë kësaj kohe para se të shpallet liria fetare pjesa katolike bën një aleanc me Francën e cila do të rrezikonte vendin sepse lufta 30 vjeqare ka shkaktuar shumë turbullira në Evropë. Në këtë kohë në pjesën veri-lindore të Zvicrës filloj një bom ekonomik në industrin e tekstitit.

Në vitin 1798 Franca e pushton Zvicrën duke emruar Republika Helvetike por në vitin 1803 me aktin e ndërmjetsimit përsëri i rikthehet emri Konfederata e Zvicrës (në Francë në pushtet ishte Napoleon Bonaparta). Në këtë kohë konfederatës i bashkohen edhe kantonet: Aargau, St Gallen, Graubünden, Ticino, Thurgau dhe Vaud. Pas disfatës së Napoleonit nga britanikët dhe prusianët (gjermanët) në Waterloo në vitin 1815 kongresi i Vjenës për herë të parë garanton zyrtarisht pavarësinë dhe neutralitetin e Zvicrës duke shtuar edhe kantonet Valais, Gjenevë dhe Neuchatel.

Lufta civile me 1847, gjatës së cilës ushtria protestante të udhëhequr nga gjenerali Dufour mposhti ligën e veqant katolike të quajtur Sonderbund ku bënte pjesë kantoni Luzern dhe kjo luftë zgjati vetëm 26 ditë. Pas fitores nga forcat e Dufour në vitin 1848 krijohet një kushtetut e re federale (shumica përdoret edhe sot) dhe Berni emrohet si kqeqytyt i Zvicrës. Me themelimin e kuvendit federal kantoneve u jipen shumë të drejta ku dhoma e ulët apo Nationalrat ka 200 anëtar të ndara nga 26 kantone në proporcion me numrin e popullsisë.

Në mungesë të mineraleve Zvicra filloj të zhvilloj industrin e ndërtimit, zhvillimin e turizmit ku bëhet edhe ndërtimi i hekurudhave etj. Gjatë viteve 1850-1860 hapen 6 banka të reja tregtare ndërsa në vitin 1863 themelohet kryqi i kuq nga Henri Dinant me seli në Gjenevë. Pas një korrupsioni politik opozita shkaktoi një lëvizje për demokraci të madhe ku në vitin 1874 rishikohet kushtetuta dhe pastaj shumë ligje federale miratohen nga referendum kombëtar për të cilin edhe sot Zvicëra mbetet e famshme për këtë. Një peticion me 50 000 nënshkrime mund të sfidoj një ligj të propozuar, me 100 000 nënshkrime mund të imponojë një votim publik mbi ndonjë çështje të re.

Pas kësaj kohe Zvicëra nuk ka pasur më luftëra duke qenë neutrale në luftën e parë dhe të dytë botërore edhe pse më vonë është kritikuar për bankat zvicerane të cilat kanë ndihmu nazistët dhe për këtë në vitin 1998 dy bankat më të mëdha UBS dhe Credit Suisse kanë ra dakord që ti paguajn 1.2 miliard dollar si kompenzim të Holokaustit të mbijetuarit dhe familjet e tyre. Edhe pse në Zvicër gjenden shumë organizata ndërkombëtare dhe ka qenë aktive në OKB zyrtarisht Zvicra bëhet antare e OKB-së në vitin 2002. Në vitin 2005 i bashkohet zonës Shengen dhe pse ende nuk është antare e BE-së.

### Arti dhe Kultura

Rajonalizmi i fortë në Zvicër e bën të vështirë të flitet për një kulturë homogjene zvicerane. Ndikimi i kulturës gjermane, franceze dhe italiane në pjesët e tyre fqinje nuk mund të mohohet. Kultura Rhaeto-romane në malet lindore të Zvicrës është e fuqishme.

Arti folklorik është mbajtur gjallë nëpër organizata në të gjithë vendin. Zvicra është shprehur më së shumti në muzikë, valle, poezi, gdhendje druri dhe qëndisje. Ekziston edhe një numër i madh i ceremonive rajonale dhe lokale. Këndimet Yodeling, pavarësisht se janë stereotipe për Zvicër, nuk është e përhapur gjerësisht dhe është e kufizuar në disa zona malore.

### Gjeografia

Zvicëra ka një relief shumë të thyer e cila mbulohet më së shumti me kodra, male dhe bjeshkë të mëdha duke bërë që natyra Zvicërane të jetë ndër më të bukurat në botë. Sipërfaqja e Zvicrës është 41 277 km<sup>2</sup> duke e radhitur në vendin e 135 në botë dhe nga e gjithë sipërfaqja 39 997 km<sup>2</sup> është tokë dhe 1280km<sup>2</sup> ujë.

Kufiri që kufizonet me shtetet tjera ka një gjatësi prej 1 852 km nga e cila 740km kufizohet me Italinë, 573 km me Francën, 334 km me Gjermaninë, 164 km me Austrinë, si dhe 41 km me Liechtenstein. Zvicëra i kushton një rëndësi të madhe mbrojtjes së ambientit dhe për këtë është e përfaqësuar në shumë organizata botërore të cilat kujdesën në mbrojtjen e natyrës në forma të ndryshme.

Temperaturat vjetore sillen pakë më të ulëta në krahasim me Kosovën por kohëve të fundit temperaturat kanë bërë një ndryshim ku pranverën e viti 2011 janë regjistruar temperaturat më të larta në krahasim me 100 vitet e fundit. Sigurisht ka shumë për të folur rreth pozitës gjeografike të Zvicrës por kësaj radhe po ndalemi këtu duke shpresuar se në një të ardhme këtë artikull do ta zgjerojm edhe më shumë.

### Popullsia

Në bazë të statistikave që i kemi të publikuara nga qeveria zvicerane në vitin 2011 Zvicra ka pasur 7 785 806 banorë prej të cilëve 1 714 004 janë të huaj. Vendet nga të cilat vijn të huajt më së shumti janë nga Evropa jugore ku më poshtë do të shihni listën në bazë të përqindjeve.


Italia 17 %, Gjermania 14.6 %, Portugalia 12 %, Serbia 10,6 % (këtu është llogaritur edhe Kosova dhe Mali i Zi), Franca 5,4 %, Turqia 4,2 %, Spanja 3,8 %, Maqedonia 3,5 %, Bosnja dhe Hercegovina 2,1 %, Kroacia 2,1 %, Austria 2,1 %, Britania e Madhe 2,1 %, vendet tjera evropiane 6,9 % dhe vendet nga kontinentet tjera 13,6 %. Sa i përket fesë Zvicëra më së shumti ka katolik 41,8 %, protestant 35,3 %, musliman 4,3 %, fe tjera 3,2 %, pa fe – ateist 11,1 %, dhe pa të dhëna janë 4,3 % e banorëve.

Në Zvicër fliten 4 gjuhë zyrtare por vetëm 3 prej tyre mirren si gjuhë zyrtare të cilat përdoren në qeverisjen administrative të konfederatës zvicerane, dhe në bazë të përqindjes renditen: gjermanisht 63,7 %, frëngjisht 20,4 %, italisht 6,5 %, gjuha romane 0,5 % dhe 9 % gjuhë tjera nga të huajt.

Nataliteti dhe mortaliteti në Zvicër ka një dallim shumë të vogël dhe nga statistikat që kemi nga 1000 banorë në vit linden 9,53 dhe vdesin 8,72 që dmth se rritja e popullsisë shkon me një intensitet të vogël. Moshja mesatare tek femrat është 84,05 vjet dhe tek meshkujt 78,4 vjet, ndërsa për nga numri i banorëve femrat kanë një përqindje më të madhe por nëse merret popullsia nën 65 vjet meshkujt kanë një përqindje pakës më të madhe.

Të ardhurat për kokë banori janë ndër më të lartat në botë ku në vitin 2010 llogariten diku afër 43 000 CHF për kokë banori ndërsa rroga mesatare sillet rreth 5000 – 6000 CHF në muaj (CHF = Franka zvicerane).

Statistikat janë të bazuara nga publikimet e qeverisë zvicerane [www.stelle.admin.ch](http://www.stelle.admin.ch)



### Qeveria

Politika e Zvicrës zhvillohet në kuadrin e një sistemi shumëpartiak si republik federale demokratike, ku Këshilli Federal i Zvicrës është kreu i qeverisë. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria dhe administrata federale dhe nuk është përqendruar në ndonjë person. Fuqia legislative federale është dhënë në qeveri dhe dy dhomat e Asamblesë Federale të Zvicrës. Gjyqësori është i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislatura. Për çdo ndryshim në kushtetutë, një referendum është i detyrueshëm, për çdo ndryshim në ligj, një referendum mund të kërkohet. Përmes referendumeve, qytetarët mund të kundërshtojnë çdo ligj i votuar nga parlamenti federal dhe përmes iniciativave mund të fusin ndryshimet në kushtetutën federale, duke e bërë Zvicra shtet më të afërt në botë për një demokraci të drejtpërdrejtë. Qeveria e Zvicrës me sistemin e qeverisjes politike daton që nga viti 1848 me themelimin e kushtetutes dhe shtetit modern. Konfederata e Zvicrës ( lat. Confoederatio Helvetica - CH) qeverisjen e bën në 3 nivele politike, Qeveria Federale, Kantonet dhe Komunitat

Zvicra përmban një sistem të qeverisjes që nuk shihet në asnjë komb tjetër. Referendumet mbi ligjet më të rëndësishme kanë qenë të përdorura që nga kushtetuta 1848. Çdo qytetar mund të kundërshtojë një ligj që është miratuar nga parlamenti. Në qoftë se personi është në gjendje të mbledhin 50.000 nënshkrime kundër ligjit brenda 100 ditësh, një votim kombëtar duhet të jetë e planifikuar ku votuesit vendosin me një shumicë të thjeshtë të votuesve nëse duhet të pranojnë apo refuzojnë ligjin. Gjithashtu, çdo qytetar mund të kërkojë një vendim për një ndryshim që ata duan të bëjnë me kushtetutën. Për këtë iniciativë një ndryshim të jetë i organizuar, nënshkrimet e 100.000 votuesve duhet të mblidhen brenda 18 muajve. Webfaqja zyrtare e qeverisë së Zvicrës është [www.admin.ch](http://www.admin.ch) ku nga kjo janë të lidhura edhe shumica e ministrive dhe organeve tjera shtetërore, si shembull kemi ministrinë e punëve të jashtme EDA [www.eda.admin.ch](http://www.eda.admin.ch)

### Ekonomia

Ekonomia e Zvicrës është një nga ekonomitë më stabile në botë. Politika e saj e afatgjatë e sigurisë monetare dhe stabiliteti politik ka bërë Zvicra të jetë një strehë i sigurt për investitorët, duke krijuar një ekonomi që është gjithnjë e varur nga një valë e qëndrueshme e investimeve të huaja. Për shkak të përmasave të vogla të vendit dhe specializimit të lartë të punës, industria dhe tregtia janë çelësat për jetesë ekonomisë së Zvicrës. Zvicra ka arritur të ardhurat për kokë banori një nga më të larta në botë me shkallën e papunësisë të ulët dhe një buxhet të balancuar. Sektori i shërbimeve ka luajtur një rol të rëndësishëm ekonomik.

Ekonomia zvicerane ndjek modelin tipik të luftës së parë botërore në lidhje me sektorët e ekonomisë. Vetëm një pakicë e vogël e punëtorëve janë të përfshirë në sektorin primar ose bujqësor (3.8% e popullsisë, në vitin 2006), ndërsa një pakicë më e madhe është e përfshirë në sektorin e mesme ose prodhimin industrial (23% në vitin 2006). Shumica e popullsisë së punës janë të përfshirë në sektorin e shërbimeve (73.2% në vitin 2006). Përderisa shumica e praktikave zvicerane ekonomike janë sjellë kryesisht në përputhje me politikat e BE-së , disa proteksionizma tregtare mbeten , veçanërisht për sektorin e vogël bujqësor.

Zvicra ka një sektor të gjerë industrial, ajo nuk është shumë e njohur në mbarë botën, por i pranishëm me kompanitë në sektorë të ndryshëm industrial si përpunimin e ushqimit sikurse Nestle, industrin kimikale, sektorin e ndërtimit si Sika AG, farmaceutike si Novartis, veshjeve Sarnafil si dhe shumë të tjera.

### Telekomunikacioni

Zvicra ka një sistem të avancuar të telekomunikacionit. Në bazë të disa statistikave, në vitin 2007 kanë qenë 5 milion linja të telefonisë fikse në përdorim dhe 8,096,000 telefonat mobil, më shumë se një për kokë banori. Sistemi telefonik është përshkruar si "shërbim i shkëlqyer vendorë dhe ndërkombëtarë" dhe ka një rrjet të shkëlqyer me mikroval.

Në vitin 1998 numri i ndegjuesve të radiove në vend ishte në 7,100,000, në vitin 2004 ka pasur 113 FM dhe 4 AM radio stacione, pa llogaritur shumë stacione të tjera të ulëta të energjisë. Gjithashtu, në vitin 1995, kishte 108 stacione televizive.

Kodi i domainit për web faqet zvicerane është .ch, i cili vjen nga emri në gjuhën latine të konfederatës, Confederation Helvetica. Në vitin 1999 ka pasur 115 Internet Service Providers në Zvicër dhe Lihtenshtaj) ndërsa në vitin 2008 4 610 000 përdoruesve të internetit.

### Transporti

Të flasim për transportin në Zvicër mund të themi është një ndër më modernit në botë dhe këtë sigurisht e kanë parë edhe shumë shqiptar të cilët kanë vizituar apo jetuar më gjatë në Zvicër. Aeroporti kryesor i cili edhe ka më së shumti fluturime pa dyshim është i Cyrihut pastaj Gjenevës, Bernit dhe Bazelit. Aeroporti i Cyrihut ofron linjat e trenit më të cilat përmes stacionit kryesor të trenave (Hauptbahnhof) mund të udhëton në çdo pjesë të Zvicrës.

Akomodimi i turistëve ofrohet edhe në shumë hotele të cilat gjinden afër aeroportëve dhe në shumë raste udhëtimi deri tek hotelet ofrohet falas nga linjat e autobusave që i ofrojnë vetë hotelet por sigurisht kjo në shumicën e rastëve tek shqiptarët nuk është një zgjidhje pasi që shumica prej nesh shkojmë tek ndonjë mik apo familjarët tonë.

Përveq transportit ajror Zvicëra e ka të zhvilluar edhe transportin rrugor dhe duke përfshirë rrjetin e trenave që menaxhohet nga ndërmarrja shtetërore më e madhja për transport në Zvicër SBB - [www.sbb.ch](http://www.sbb.ch) Më poshtë shikoni disa statistika të transportit publikuar në vitin 2010: Zvicëra ka 65 aeroporte, 1 fushë të helikopterëve, linja të trenit 4 888 km, rrugë për automjete 71 454 km, kanala të lundrueshme 1 299 km, 1 port i cili gjendet në Bazel.

Ky ishte vetëm një përshkrim i shkurtër rreth transportit në Zvicër ndërsa ne në të ardhmen do të punojmë edhe disa broshura rreth shfrytëzimit sa më të lehtë të transportit në Zvicër.

### Turizmi

Turizmi është një ndër bizneset më të mëdha në Zvicër ku disa nga malet më të larta në botë, qendrat urbane, festivalet e ndryshme dhe shumë gjëra tjera e bëjnë Zvicrën një vend të veçantë për turistët. Bukuritë natyrore të cilat mund të thuhet se janë ndër më të bukurat në botë Zvicrës i kanë sjellur shumë atraksione ku edhe numri i turistëve të huaj në vit sillet rreth 10 milion.

Përveq kënaqësisë që i sjell Zvicra turistëve me atraksione të ndryshme, turizmi luan një rol të madh edhe tek popullata zvicëriane pasi që punëson një numër të madh ku në bazë të statistikave nga numri i përgjithshëm i fuqisë punëtore thuhet se vetëm turizmi arrin në 10 % dhe duke krahasuar me eksportin e përgjithshëm turizmi zën vendin e tretë. Nga 26 kantonet e Zvicrës të gjitha kanë forma apo broshura të veçanta me informacione të ndryshme rreth turizmit të cilat ofrohen në disa gjuhë.

Promovimit të turizmit qeveria i kushton një rëndësi të madhe dhe pasi

që çdo vit konkurrenca rritet nga vende të ndryshme Zvicra bën një promovim për të përfutur turist nga e tërë bota por në veqanti nga vendet aziatike duke pasur si qafe Kinën dhe Indin.

Turistët e vizitojnë Zvicrën gjatë tërë vitit por në disa javë të pranverës dhe vjeshtës numri pak është ma i ulët. Gjatë verës turistët mund të shijojnë shëtitjet nëpër natyrë, muzet, festivale të ndryshme dhe shumë ngjarje tjera ndërsa gjatë dimrit turistët zakonisht vizitojnë vendet malore ku ka një numër të madh qendrash sportive dimrore. Përveq turistëve Zvicrën e vizitojnë edhe shumë personalitete, biznismen etj pasi që në Zvicër gjenden shumë organizata, mbahen shumë takime si dhe ka shumë biznese nga e gjithë bota.

Sa i përket transportit Zvicëra ka një sistem shumë të zhvilluar ku çdo qytet është i lidhur me linjat e trenit dhe gjithashtu ka edhe linja të autobusave. Karakteristik e veçantë tek linja e trenave është edhe udhëtimi nëpër zonat e larta malore ku linjat e trenit shkojnë deri në 3600 m lartësi mbidetare duke përshkruar një rrugë me disa orë dhe me pamje të ndryshme e sidomos kur moti është i kthjellët.

Ka shumë e shumë gjëra tjera për të shkruar rreth turizmit në Zvicër por kësaj radhe ne po e përfundojmë këtu duke ju premtuar se në të ardhmen do t'ju sjellim edhe shumë materiale tjera që shpresoj se ata të cilët e vizitojnë Zvicrën do ta shijojnë një kënaqësi të vërtetë me atraksionet që i sjell ky vend.



### Shoqëria

Zvicra ka një shoqëri moderne dhe mendje-hapur. Shumica e njerëzve janë mirë të arsimuar dhe gëzojnë një standard të lartë të jetesës, si dhe liri të mjaftueshme që të jenë në gjendje të planifikojnë jetën e tyre ashtu siq e shohin vetë.

Shoqëria zvicerane është shënuar nga një pluralizëm i jetesës dhe një shumëllojshmëri etnike dhe kulturore. Pavarësisht nga ndryshimet në shoqëri, familja mbetet grupi më i rëndësishëm i referimit social. Shumica e njerëzve kanë trajnim të mirë profesional, një standard të lartë të jetës në kushtet ndërkombëtare dhe fushë të përshtatshme për formësimin e jetës së tyre personale.

### Emigrantet

Në krahasim me vendet tjera evropiane numri i të huajve që marrin shtetësinë zvicerane, është mjaft i ulët, ndonëse një në çdo 10 të rritur që mbajnë shtetësinë zvicerane në vitin 2001 kishte fituar atë nëpërmjet natyralizimit. Ndërmjet viteve 1992 dhe 2005 numri vjetor i natyralizimit është trefishuar ku 3/4 e tyre vijn nga Evropa dhe 1/3 ishin të lindur në Zvicër. Një e treta e njerëzve që jetojnë në Zvicër në të njëjtin vit ishin ose vetë emigrantët apo pasardhësit e emigrantëve, sipas Zyrës Federale të Statistikave.

Proporcioni i të huajve në popullatën rezidente është i lartë, duke qëndruar në 21.7% në vitin 2008, edhe pse ata janë tepër të pa barabart. Në Evropë vetëm Luksemburg dhe Lihtenshtajni kanë proporcione më të larta.

Përqindja e të huajve është veçanërisht e lartë në mesin e fëmijëve. Regjistrimet tregojn se 25.8% e fëmijëve nën 6 vjeç nuk kanë shtetësinë zvicerane. Në pesë qytetet më të mëdha 45% e fëmijëve në këtë varg moshë nuk janë zvicerane. Rreth 1/5 e fëmijëve të lindur në Zvicër kanë të paktën një prind të huaj.

Në fund të vitit 2006, 21.4% e të huajve rezidentë në Zvicër ka ardhur nga një nga shtetet pasuese të ish-Jugosllavisë. Shumica dërrmuese e banorëve të huaj, 86,5% në 2006, vjen nga Evropa, por përqindja e të cilit në shtëpi vende janë më larg vazhdon të rritet.

Gati një e katërta e këtyre banorëve të huaj kanë lindur dhe janë rritur në Zvicër, disa prej tyre tani kanë fëmijët e tyre. Gjeneratës së dytë të huaj i referohen shpesh si secondos (ose secondas, për gratë).

### Burimet

Të gjitha këto burime janë të bazuara nga

Swissinfo [www.swissinfo.ch](http://www.swissinfo.ch)

Portali Qeveritar [www.admin.ch](http://www.admin.ch)

Portali i Zvicrës [www.ch.ch](http://www.ch.ch)

Portali zyrtar i turizmit [www.myswitzerland.com](http://www.myswitzerland.com)

Wikipedia [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)

**Autor:**  
**Faton Krasniqi**